



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirilli dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup  
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 [www.kzk.gov.mk](http://www.kzk.gov.mk) e-mail: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk)



Njoftimi i përqendrimit në mes të "Ballkan Petroleum Holding Limited", Londër, Mbretëria e Bashkuar dhe Makpetrol Shoqëria Aksionare për tregtinë e naftës dhe derivateve të naftës Shkup, (lënda nr. 08-37/2016)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare nr. 145 / 10, 136/11 dhe 41/14), me datën 04.07.2016, dhe plotësuar me 26.07.2016 dhe 04.08.2016, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës merr njoftimin e përqendrimit me të cilin „ Ballkan Petroleum Holding Limited”, rr. C/O NJSM Connect House, 133-137 Aleksandra Road Vimblon, Londër Mbretëria e Bashkuar ( C/O WSM, Connect House, 133-137 Alexandra Road Wimbledon, London, United Kingdom ) ka për qëllim të fiton kontrollin e Makpetrol Shoqëria Aksionare për tregtinë e naftës dhe derivateve të naftës Shkup, rr. Sv. Kirili dhe Metodij nr. 4 Shkup.

1. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- „Ballkan Petroleum Holding Limited” është e themeluar në vitin 2016 dhe është e regjistruar të kryejë veprimtarin e biznesit si një shoqëri e përgjithshme tregtare.
- Makpetrol Shoqëria Aksionare për tregtinë e naftës dhe derivateve të naftës Shkup (Makpetrol SHA Shkup) merret me tregtinë e naftës me shumice dhe pakicë, derivatet e naftës, gazin natyror dhe bionaftës.

Makpetrol SHA Shkup, në Republikën e Maqedonisë i ka këto kompani:

- „ Shoqëria radiodifuzive tregtare TELEVISIONI MAKPETROL SHPKNJP Shkup” rr. Nikolla Parapunov nr. 51 Shkup, merret me veprimtarin e programeve televizive dhe transmetimit.
- „ Shoqëria e tregtisë dhe shërbimeve SHAMPION Makpetrol SHPKNJP import-eksport Shkup” rr. Sv. Kiril dhe Metodij nr. 4 Shkup, merret me veprimtarinë e ndërmjetësimit në tregti me produkte të ndryshme.
- „ Shoqëria e tregtisë MAKPETROL PROM- GAS SHPKNJP Shkup” rr. Sv. Kiril dhe Metodij nr. 4 Shkup merret me veprimtarin e tregtisë me shumicë të derivateve të ngurta, të lëngëta, të gazit dhe produkteve të ngjashme . MAKPETROL PROM- GAS SHPKNJP Shkup është furnizuesi i vetëm aktiv në tregun e Maqedonisë që merret me gazin natyror.



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup  
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 [www.kzk.gov.mk](http://www.kzk.gov.mk) e-mail: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk)



- „Shoqëria Aksionare GA-MA Shkup” rr. Sv. Kiril dhe Metodij nr. 4 Shkup, merret me veprimtarin e transportit të gypave. SHA GA-MA ka licencë për veprimtarinë – transportimin e gazit natyror.

1. Në bazë të shqyrtimit paraprak Komisioni konstaton se përqendrimi në shqyrtim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.
2. Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi 54, Shkup ose me email: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk) dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

17.08.2016  
Shkup